

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Jonuz Bugari, si kryetar i trupit gjykues, gjyqtarëve porot: **Selami Gashi** dhe **Mustafë Cena**, anëtar të trupit gjykues, me bashkëpunëtorin profesional **Armond Omega**, në çështjen juridike të propozuesit F. A. K. nga fshati B., Komuna e Rahovecit, të cilën e përfaqëson avokati M. B. nga Rahoveci, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, dhe propozueses E. I. K. e lindur J. nga Prizreni, të cilin e përfaqëson Av. G. Sh. nga Rahoveci, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, për shkak të zgjidhjes së martesës me marrëveshje, pas mbajtjes dhe përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor jo publik dhe zbatimit të provave, më **18.05.2018**, morri këtë:

A K T G J Y K I M

ZGJIDHET ME MARRËVESHJE martesë në mes të propozuesit **F. K.**, i lindur më ..., dhe propozueses **E. K.** e lindur **J.**, lindur më ..., martesë e lidhur më ..., në Luzern - Zvicër, e regjistruar në Zyrën e Gjendjes Civile në Rahovec - Xërxë, me nr. ser. **M ...**, me nr. rendor ..., dhe me numër të referencës **16|2017RM|16003/Sp.**

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Propozuesit F. K. dhe E. K. e lindur J., nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar në këtë gjykatë kanë parashtruar propozim të përbashkët për zgjidhjen e martesës me marrëveshje, kanë cekur se me rastin e lidhjes së martesës, marrëdhëniet bashkëshortore kanë qenë plotësisht normale, për një kohë të shkurtër ato kanë filluar që të acarohen dhe marrëdhëniet midis bashkëshortëve kanë filluar të bëhen të padurueshme, për shkak të mentalitetit të ndryshëm të bashkëshortëve dhe kuptimeve të vazhdueshme, bashkëshortët faktikisht kanë bashkëjetuar vetëm 2 deri 3 muaj pas lidhjes së martesës.

Në lidhje me këtë çështje juridike gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor për datën 18.05.2018, në të cilën seancë është paraqitur përfaqësuesi i autorizuar i propozuesit M. B. dhe përfaqësuesi i autorizuar i propozueses së dytë Av. G. Sh..

Përfaqësuesi i autorizuar i propozuesit të parë ka deklaruar se mbetet në tërësi sipas propozimit të ushtruar për zgjidhjen e martesës me marrëveshje, bashkëshortët kanë bashkëjetuar vetëm 2 deri 3 muaj pas kësaj kohe kanë lindur mosmarrëveshje, mospajtime, janë çrregulluar në tërësi raportet bashkëshortore, për shkak të keqkuptimeve dhe mentalitetit janë ndarë, dhe kanë interes që të zgjidhin martesën pasi që nuk ekzistojnë gjasat minimale për vazhdimin e jetës së përbashkët të bashkëshortëve. Palët gjatë martesës nuk kanë lind fëmijë e as nuk presin lindjen e fëmijës, e duke pasur parasysh se janë plotësuar kushtet të parapara ligjore për zgjidhjen e martesës, dhe i propozoj gjykatës që të aprovojë propozimin në tërësi sipas marrëveshjes.

Përfaqësuesi i autorizuar i propozueses së dytë deklaroi se ngel në tërësi pranë propozimit të përbashkët për zgjidhjen e martesës me marrëveshje, duke shtuar se propozuesit pikërisht më datë ..., kanë lidhur martesë në Luzern të Zvicrës, e cila martesë është e regjistruar në Zyrën e Gjendjes Civile në Xërxë, po ashtu ka theksuar se bashkëshortët në fillim kanë pasur raportet të mira bashkëshortore por më vonë për shkak të botëkuptimeve të ndryshme dhe mentalitetit raportet janë keqësuar dhe ka ardhur deri te ndarja faktike në mes të tyre, dhe se nga kjo martesë palët nuk kanë fëmijë e as nuk presin lindjen e fëmijës. Andaj i propozoj që martesë të zgjidhet me marrëveshje me propozim të përbashkët.

Gjykata, për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike ka bërë administrimin e provave dhe atë: ka bërë shikimin e certifikatës së martesës ser. M ..., me nr. rendor ..., dhe me numër të referencës 16|2017RM|16003/Sp, e lëshuar pranë Zyrës së Gjendjes Civile në Rahovec, Xërxë, më 22.02.2018.

Pas analizimit dhe vlerësimit të provave, në bazë të bindjes së lirë, e duke u bazuar në nenin 8 të LPK-së, është konstatuar se propozimi i përbashkët i propozuesve për zgjidhjen e martesës me marrëveshje, është i bazuar dhe i njëjti është aprovuar.

Me shikimin në certifikatën e martesës me nr. serik M ..., e lëshuar pranë Zyrës së Gjendjes Civile në Rahovec, Xërxë, më 22.02.2018, vërtetohet se F. K., i lindur më ..., dhe propozueses E. K. e lindur J., lindur më ..., martesë e lidhur më ..., në Luzern - Zvicër, e regjistruar në Zyrën e Gjendjes Civile në Rahovec - Xërxë.

Si fakt relevant në këtë çështje juridike gjykata muar për bazë se propozimin për zgjidhjen e martesës me marrëveshje palët e kanë bërë bashkërisht, kanë jetuar së bashku vetëm tre muaj dhe se ata ka një kohë që jetojnë ndaras sipas deklaramit të tyre.

Andaj në bazë të gjendjes faktike të cekur më lartë dhe duke u bazuar në dispozitat neneve 68, 69 dhe 84 të Ligjit mbi Familjen i Kosovës dhe nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është mbështetur në dispozitën e nenit 450 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
C.nr. 60/2018, më 18.05.2018.

B. Profesional
Armond Qmega

Kryetari i trupit gjykues
Jonuz Bugari

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, ankesa paraqitet ndërmjet kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit Divizioni Civil në Prishtinë.